



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

Numri i lëndës: 2020:069782
Datë: 07.03.2024
Numri i dokumentit: 05424628

E.nr.1597/22

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ, gjyqtari Faton Ajvazi me sekretaren juridike Makfire Reçica, duke vendosur në çështjen juridike përbarimore të kreditorit L.R. nga Prishtina, të cilën e përfaqëson av Leutrim Ademi nga Mitrovica, kundër debitorit Universiteti i Shkencave të Aplikuara në Ferizaj, për pagesën e borxhit dhe shpenzimeve të procedurës, më datë 07.03.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

PËRFUNDON procedura përbarimore në lëndën **E.nr.1597/22**, për shkak të përmbushjes së kërkesës së kreditorit.

A r s y e t i m i

Gjykata Themelore në Ferizaj, me aktvendimin E.nr.1597/22, të datës 19.12.2022, e ka caktuar përbarimin e propozuar nga i autorizuari i kreditorit, kundër debitorit Universiteti i Shkencave të Aplikuara në Ferizaj, për pagesën e borxhit dhe shpenzimeve të procedurës, në bazë të aktgjykimit C.nr.994/20, të datës 05.01.2021.

Meqenëse aktvendimi mbi lejimin e përbarimit është bërë i formës së prerë dhe i ekzekutueshëm, gjykata me aktvendimet e datës 13.03.2023 dhe 07.03.2024, e ka urdhëruar Thesarin e Kosovës, që nga llogaria e debitorit, t'i transferoj shumat e mjeteve prej 1,677.00 euro, 276 euro, në llogarinë e të autorizuarit të kreditorit dhe shumën e mjeteve prej 100 euro, në llogarinë e ekspertes financiare gjyqësore Filloreta Sadriu.

Meqenëse kreditori e ka realizuar kërkesën e saj, Gjykata konstatoj se janë përmbushur kushtet ligjore nga neni 66, par 4, të LPP-së, dhe vendosi që ta përfundoj procedurën përbarimore në këtë çështje juridike përbarimore.

Nga sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ
E.nr.1597/22, më datë 07.03.2024

GJYQTARI
Faton Ajvazi